

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“DIGISIGN” SH.P.K.**  
**DATË 25.05.2021**

Sot, në datën 21.05.2021, **Z.Flamur Kelmendi**, shtetas kosovar, lindur më 06.05.1984, në Qyshk, dhe banues në Pejë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit të Republikës së Kosovës /ID me nr. ID0647922 dhe nr. personal 1003691213 dhe **Z.Besnik Zabërgja**, shtetas kosovar, lindur më 30.07.1975, në Mitrovicë dhe banues në Prishtinë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit të Republikës së Kosovës /ID me nr.ID05947143 dhe nr. Personal 2010945197, në cilësinë e Ortakëve Themelues, vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar **“DigiSign” Shpk**. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi, si Shtojca A.

**NENI 1 – EMËRTIMI**

1.1 Shoqëria emërtohet **“DigiSign” Shpk**.

**NENI 2 – FORMA**

2.1 Shoqëria **“DigiSign” Shpk** themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**NENI 3 – SELIA**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga Vllazën Huta, Ap.13 Njësia Bashkiake Nr.1, Nr.Pasurie4/38+1-13, volum 23, fq.24, ZK8150, 1017, Tiranë, Shqipëri.



- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresa të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresa sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

#### **NENI 4 – OBJEKTI**

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:

- A. Krijimin, zhvillimin dhe implementimin e programeve software, telekomunikacionit, teknologjisë informative, të realizuara prej saj ose personave të tretë.*
- B. Realizimin e zhvillimit, shitjes dhe implementimit të tyre.*
- C. Dizenjimin dhe zhvillimin e sistemeve të komunikimit, sigurisë dhe sistemeve të migrimit.*
- D. Operim, menaxhim dhe suporti përdorimit dhe auditimit teknik/informatik për sistemet software dhe hardware.*
- E. Projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike, përfshirë edhe tregëtimin me shumicë dhe pakicë të programeve, pajisjeve elektronike dhe kompjuterike.*
- F. Shoqëria mund të kryejë transaksione tregtare dhe të bashkëpunojë apo të lidhë marrëveshje me kompanitë huaja.*

#### **NENI 5 – KOHËZGJATJA**

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT**

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i ndarë në 2 kuota të zotëruara nga ortakët themelues në masën 50% nga Z.Flamur Kelmendi dhe 50% nga Z.Besnik Zabërgja, të kontributit në kapital.

- 6.2 Kuotat e Ortakëve të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë, pasi të jetë ezauruar më parë e drejta e parablerjes e secilit prej ortakëve për kuotën në shitje/ tjetërsim të ortakut tjetër.
- 6.3 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga Ortakët Themelues, në masën 50% nga Z.Flamur Kelmendi dhe 50% nga Z.Besnik Zabërgja.
- 6.4 Secili nga Ortakët e Shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

#### **NENI 7 –TRANSFERIMI I KUOTAVE**

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

#### **NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT**

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojnë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme (“ad negotia”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.
- 8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:  
*“Z.Flamur Kelmendi, shtetas kosovar, lindur më 06.05.1984, në Qyshk, dhe banues në Pejë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit*

ID me nr. ID0647922 dhe nr. personal 1003691213.

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër <u>FLAMUR KELMENDI</u>	Nënshkrimi <u>Flamur</u>
-------------------------------------	--------------------------

**NENI 9 – GJUHA**

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

**NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT**

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

\*\*\*

**“DIGISIGN” sh.p.k.**

**ORTAKËT THEMELUES:**

**Z. Flamur Kelmendi**

FLAMUR KELMENDI 

**Z. Besnik Zagërgja**

BESNIK ZABERGJA 

